

RAPORT MONITORUES MBI PJESËMARRJEN POLITIKE, SOCIALE, EKONOMIKE TË TË RINJVE NË SHQIPËRI

Përmbledhje

Partners Albania for Change and Development

PËRMBAJTJA

RAPORTIT

- 1 Përmbledhje
- 2 Të dhëna mbi Pjesëmarrjen Politike, Sociale dhe Ekonomike të të Rinjve
- 3 Krahasim i të Dhënave të Monitoruara përgjatë tre viteve
- 4 Çështje për Advokim dhe Rekomandime

"Mungesa e të dhënave zyrtare të përditësuara mbi përfshirjen e të rinjve mbetet një çështje për tu adresuar"

Partnerët Shqipëri në kuadër të projektit “Youth Bank Hub për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë”, zbatuar në bashkëpunim me Fondacionin “Ana I Vlade Divac” në Serbi, Shoqatën për Edukim- MLADIINFO International në Maqedoni, Organizatën “Prima” në Mal të Zi dhe Fondacionin “Community Volunteers” në Turqi, çdo vit publikon një raport monitorues me qëllim pasqyrimin e situatës dhe analizimin e të dhënave mbi përfshirjen politike, sociale dhe ekonomike të të rinjve në Shqipëri.

Raporti i monitorimit shërben si udhëzues për rekomandimet të bazuara në prova dhe nismat e avokimit të rrjetit në lidhje me pjesëmarrjen e të rinjve.

Raporti ofron një përshkrim të shkurtër të të dhënave aktuale mbi pjesëmarrjen politike, sociale dhe ekonomike të të rinjve në Shqipëri bazuar në matjen e një seti treguesish të mirëpërkufizuara. Duke marrë parasysh që ky është raporti i tretë vjetor, ai ofron disa krahasime të rëndësishëm të të dhënave gjatë tre viteve të monitorimit 2016 - 2018.

Të dhënat e raportit janë rezultat i kërkimeve nga të dhëna sekondare dhe raporte ekzistuese si dhe informacionin e marrë nëpërmjet kërkesave zyrtare dërguar pranë: Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Ministrisë së Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale, Institutit të Statistikave dhe Bashkive të Shqipërisë.

Raporti ofron rekomandime dhe iniciativa për advokim në të ardhmen në lidhje me përmirësimin e situatës së përfshirjes politike, sociale dhe ekonomike të të rinjve.

Të dhënat e këtij raporti pasqyrohen në Indeksin e Rinisë, bazuar mbi 5 raportet e vendit të rrjetit YBH.

Të Dhëna mbi Pjesëmarrjen Politike të të Rinjve

Treguesit	Të Dhënat	Viti
Të rinjtë Ministra në Qeveri M/F	0.0%	2018
Të rinjtë Zëvendës Ministra në Qeveri M/F	3.0%	2018
Të rinjtë Deputetë në Parlament M/F	4.9%	2018
Të rinjtë Kryetarë të Bashkive	6.0%	2015-2018
Mjete të komunikimit online për informim dhe pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse në qeveri dhe parlament	93.3%	2018
Mjete të komunikimit online për informim dhe pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse në bashki	67.2%	2018
Struktura kombëtar të përfaqësimit rinor (këshill/parlament/bord)	0.0%	2018
Struktura lokale të përfaqësimit rinor (këshill/parlament/bord)	49.0%	2018

Të Dhëna mbi Pjesëmarrjen Sociale të të Rinjve

Indicators	DATA	YEAR	Të Dhënat	Viti
Young ministers in Government M/F	Treguesit	0.0%	2018	
Young deputy ministers in government M/F		3.0%	2018	
Young MPs in the parliament M/F	Të rinjtë në risk vënie	4.9%	2018	15%
Young mayors	Të rinjtë në varfëri	6.0%	2015-2018	2012 ¹
On-line tools for information and participation in decision making of government and parliament	Të rinjtë në burgje	93.3%	2018	Nuk ka të dhëna
On-line tools for information and participation in decision making of municipalities	Të rinjtë si pjesë e Sistemit të Mbrojtjes Sociale	67.2%	2018	47.7%
Existence of youth structure (councils/parliaments/unions) on national level	Të rinjtë të larguar nga shkolla e mesme	0.0%	2018	Nuk ka të dhëna ³
Existence of youth structure (councils/parliaments/unions) on local level	Të rinjtë e rregjistruar në universitete	49.0%	2018	3.2%
	Të rinjtë të diplomuar në universitete			53,9%
				2017-2018 ⁴
				2017-2018 ⁵
				2017-2018 ⁶

¹ Publikimi i fundit i Instat më daton 2012

http://www.instat.gov.al/media/1312/living_standart_measurement_survey_2012_revised.pdf

² Kërkesë për informacion Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

³ PSH dërgoi kërkesë për informacion pranë Ministrisë së Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale por ende nuk ka marrë përgjigje.

⁴ Kërkesë për informacion Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit

⁵ Kërkesë për informacion Instat

⁶ Kërkesë për informacion Instat

Të Dhëna mbi Pjesëmarrjen Ekonomike të të Rinjve

Treguesit	Të Dhënat	Viti
Norma e të Rinjve jo në Punësim, Arsim apo Trajnim	28.6%	2018
Norma e Papunësisë së të Rinjve	23.1%	2018
Norma e Papunësisë Afatgjatë të të Rinjve	13.1%	2018
Norma e Pjesëmarrjes në Forcën e Punës së të Rinjve	50.1%	2018
Norma e Punësimit të të Rinjve	38.5%	2018
Të rinj që kanë përfituar mbështetje financiare nga shteti për të ngritur një start-up	Nuk ka të dhëna ⁷	
Të rinj të vetëpunësuar	0.9%	2018

Krahasimi i të Dhënave të Monitoruara përgjatë 3 viteve

Bazuar në monitorimin tre vjeçar të përfshirjes së të rinjve në politike, sferën sociale dhe ekonomike, në përgjithësi treguesit nuk tregojnë ndonjë përmirësim domethënës.

Pjesëmarrja politike e të rinjve në dy vitet e fundit është përmirësuar në krahasim me vitin 2016, por pas ngjarjeve më të fundit politike të 2019, në të cilat partitë opozitare dogjën mandatet e tyre politike dhe vendosën të mos marrin pjesë në zgjedhjet lokale të mbajtura në qershor, pjesëmarrja politike e të rinjve për vitin 2019 nuk pritet të rritet. Përkundrazi, situata mund të përkeqësohet.

Numri i të rinjve në burg është rritur me 11.2% gjatë kësaj periudhe tre-vjeçare. Mungesa e të dhënave që nga viti 2012 për kushtet e jetesës së të rinjve dhe të dhënat e mbledhura pjesërisht për përfshirjen e të rinjve në sistemin e mbrojtjes sociale, tregojnë një përkeqësim të gjendjes së pjesëmarrjes së të rinjve.

Sa i përket pjesëmarrjes ekonomike të të rinjve, vërehet një përmirësim i vogël gjatë këtyre tre viteve, me uljen e shkallës së papunësisë së të rinjve me 5.8% dhe rritjes me 6.1% të raportit të punësimit. Të dhënat për të rinjtë e vetëpunësuar janë ulur ndjeshëm për shkak të një ndryshimi në metodologji. Këtë vit treguesi llogarit numrin e të rinjve të regjistruar të vetëpunësuar në krahasim me popullsinë e të rinjve në vitin 2018 nga INSTAT, ndryshe nga dy vitet e fundit ku është krahasuar me numrin e të vetëpunësuarve të regjistruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave. Për më tepër, mungesa e të dhënave për mbështetjen e qeverisë në lidhje me biznesin fillestar të të rinjve është një tregues tjetër që tregon pjesëmarrje të ulët ekonomike të të rinjve gjatë gjithë periudhës tre vjeçare të monitorimit.

⁷ PSH dërgoi kërkesë për informacion pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë por ende nuk ka marrë përgjigje.

Çështje për Advokim dhe Rekomandime

Në vitin e tretë radhazi të monitorimit, mungesa e të dhënave statistikore për të rinjtë në nivel kombëtar dhe lokal mbetet ende sfidë. Kjo haset kryesisht në treguesit e pjesëmarrjes sociale, por edhe në ato ekonomike, veçanërisht në mbështetjen e qeverisë për nismat e biznesit të të rinjve. Për më tepër, dy nga Ministritë përgjegjëse për shpërndarjen e këtyre skemave nuk iu përgjigjën kërkesës zyrtare të dërguar nga PSH, mbi të dhënat e mësipërme.

Pjesëmarrja Politike e të Rinjve

- Pavarësisht nismës së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për hartimin dhe miratimin e Ligjit për Rininë deri në fund të vitit 2018, ende nuk ka një ligj të tillë. Për më tepër, vlen të përmendet se në projektligjin përfundimtar të rinisë, rekomandimet e OSHC-ve nuk ishin pasqyruar. Ky projektligj u kundërshtua nga kjo e fundit posaçërisht për nenin 13 për krijimin e një strukture kombëtare të përfaqësimit të të rinjve nën varësinë e ministrisë.
- Pavarësisht angazhimeve strategjike të përcaktuara në Planin Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015-2020, në krijimin e strukturave përfaqësuese të të rinjve në të dy nivelet ende në nivelin kombëtar nuk ka strukturë rinore dhe në nivelin lokal më shumë se gjysma e komunave nuk ka as një strukturë të tillë.
- Partitë politike duhet të përmirësojnë qasjen e tyre për të rritur pjesëmarrjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe demokratike. Duhet të rritet pjesëmarrja e të rinjve në pozicione ekzekutive në nivel lokal dhe qendror. Modelet e sukseshme të Lidërshiptit Rinor në politikë si deputetë të rinj, kryetarë bashkie të rinj apo zëvendës ministrat të rinj duhen promovuar më tepër.

Pjesëmarrja Sociale e të Rinjve

- Arsimi është fusha kryesore që ka nevojë për ndërhyrje, përmes përshtatjes së kurrikulave për arsimin fillor dhe 9-vjeçar, duke përfshirë aktivitete ekstrakurrikulare si klube sportive, arti, ku të rinjtë mund të ndajnë interesat dhe pasionet e përbashkëta dhe mund të angazhohen në jetën sociale, duke i mbajtur të rinjtë larg krimit dhe aktiviteteve të paligjshme. Me qëllim rritjen e cilësisë së arsimit dhe njëkohësisht aftësive për jetën, duhet të krijohen klube sociale dhe debati në shkollat e mesme.
- Më shumë fokus duhet t'i kushtohet këshillimit të karrierës, veçanërisht krijimit të qendrave të këshillimit të karrierës në shkollat e mesme duke vënë në dispozicion staf profesional dhe të kualifikuar për të ofruar këshillimin.
- Duhet të rritet numri i hapësirave publike të dedikuara për aktivitete rinore sportive dhe kulturore.
- Programet e riintegritit duhet të përshtaten për të rinjtë në burgje⁸, sipas nevojave dhe situatës së tyre. Këto programe duhet të kontribuojnë në fuqizimin e kapaciteteve të të rinjve në aftësitë e ndryshme për jetën dhe trajnimin profesional, duke i përgatitur ata për jetën jashtë burgut.
- Duhet të krijohen skema mbështetëse të dedikuara për emigrantët e rikthyer, si për shembull duke krijuar mundësi të reja punësimi, ofrimin e granteve për start-upe, trajnime profesionale, njehsimin e çertifikatave të marra nga jashtë, ofrimin e shërbimeve psiko-sociale për fëmijët dhe të rinjtë që kanë vështirësi të përshtaten në shkollë etj.

Pjesëmarrja Ekonomike e të Rinjve

- Një nga çështjet për advokim është reduktimi i nivelit të lartë të papunësisë, përmes fuqizimit të mekanizmave për kërkimin dhe aksesin

⁸ Përqindja e të rinjve në burgje llogaritet si numri i të rinjve në burgje, i ndarë me numrin e përgjithshëm të njerëzve në burgjet në Shqipëri.

në mundësitë e punësimit, investimin në më shumë mjete online informimi dhe shërbime profesionale që mundësojnë krijimin e aftësive lidhur me punën.

- Ekziston nevoja për krijimin e qendrave të këshillimit për karrierë jo vetëm në universitete, por edhe në shkolla të mesme, si dhe hulumtime në tregun e punës për të informuar studentët për profesionin e ardhshëm, duke përafruar pasionin e tyre me nevojat e tregut.
- Gjatë viteve të fundit, promovimi i arsimit profesional dhe orientimi i studentëve drejt arsimit profesional ka qenë një nga politikat prioritare të qeverisë. Përditësimi i kurrikulave profesionale bazuar në nevojat e tregut të punës është i rëndësishëm, për të siguruar punësimin e të rinjve të diplomuar nga këto institucione.
- Është e rëndësishme të krijohet një mjedis mundësues për zhvillimin e iniciativave të vetë-punësimit, ndërtimin e aftësive sipërmarrëse si dhe lehtësimin e aksesit në kredi. Mungesa e fondeve për start-upe të ofruara nga shteti mbetet një çështje që ofron mundësi të kufizuara për sipërmarrësit e rinj. Edhe pse Minitria e Financave dhe Ekonomisë ofron skema mbështetëse për start-upet për sipërmarrësit e vegjël dhe të mesëm, duhet të ketë më shumë promovim dhe transparencë mbi përfitimin nga këto skema dhe përdorimin e fondeve.